



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

## **XHAFAJ Fatmir** Ministër i Brendshëm



CV e shkurtër e ministrit të Brendshëm, zotit Fatmir Xhafaj, emëruar në detyrë në 13 Shtator 2017.

Zoti **Fatmir Xhafaj** u lind më 17 maj 1959, në qytetin e Vlorës. Është i martuar me zonjën Mimoza Xhafaj (Berberi). Ata janë prindër të dy vajzave. Ai është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, në vitin 1982.

Në periudhën 1982-1985, zoti Xhafaj ka punuar në rrethin e Krujës në detyrën e Këshilltarit Ligjor dhe Gjyqtarit, në Gjykatën e këtij rrethi (1982-1984) dhe Hetues në Hetuesinë e rrethit, pjesë e sistemit të drejtësisë, pranë Prokurorisë së rrethit Krujë (1984-1985).

Në periudhën 1986-1990, ai ka qënë drejtues i Organizatës së Rinisë, të rrethit Tiranë dhe në periudhën 1991-1992, drejtues i Federatës së Rinisë të rrethit Tiranë.

Zoti Xhafaj mban titullin Avokat që nga viti 1992, profesion të cilin e ka ushtruar në periudhën 1993-1997 dhe për disa kohë edhe në periudhën 1999-2000.

Në periudhën 1997-1999, ai ka qënë Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2002, ka qënë Ministër i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, ndërsa në periudhën 2004-2005, ka qënë Ministër i Drejtësisë.

Në periudhën mars-maj 2017, zoti Xhafaj ka ushtruar detyrën e Ministrit të Punëve të Brendshme.

Zoti Xhafaj është zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë në pesë legjislatura rradhazi, si përfaqësues i Partisë Socialiste. Në Legjislaturën e V (2001-2005) dhe VI (2005-2009) është zgjedhur deputet i rrethit të Pogradecit, Qarku Korçë, ndërsa në Legjislaturën e VII (2009-2013) dhe VIII (2013-2017) ai është zgjedhur deputet në Qarkun e Tiranës.

Në dy legjislatura, 2005-2009 dhe 2009-2013, ai ishte Zv/Kryetar i Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, si përfaqësues i opozitës.

Në legjislaturën 2013-2017, zoti Xhafaj ishte Kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, të Drejtat e Njeriut dhe Administratën Publike.

Në të njëjtën periudhë, ai ishte edhe anëtar i Komitetit të Përbashkët Parlamentar BE-Shqipëri.

Gjatë karrierës së tij të gjatë parlamentare, zoti Xhafaj ka qënë anëtar dhe/ose drejtues i disa Komisioneve të Posaçme Hetimore parlamentare (2003, 2006, 2009 etj), si dhe anëtar dhe/ose drejtues i disa Komisioneve të Posaçme parlamentare për Reformën Zgjedhore (2003, 2007, 2008, etj).

Ai është inicues dhe autor i disa iniciativave kushtetuese e ligjore në Kuvendin e Shqipërisë.

Zoti Xhafaj ka drejtuar dhe koordinuar të gjithë procesin e reformimit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë (2014-2017).

Që nga viti 2003, zoti Xhafaj është anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste të Shqipërisë. Në periudhën 2007-2016, ai ka qënë Sekretar i Partisë Socialiste për Koordinimin dhe Çështjet Ligjore.

Që prej **13 shtatorit 2017**, është emëruar në detyrën e Ministrit të

